

12.09.2024

Ora 13:30

RENDI I DITËS


“Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 12, datë 10.09.2024 të depozituar nga zoti Astrit Fadil Kaziu”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa, z. Ilir Rusmali,
z. Koli Bele.
- **Stafi KQZ:** Znj. Madalena Koja, z. Erdal Mema
- **Parti Politike:** S’ka
- **Të tjerë:** S’ka

Z. E. Çefa: Çelim seancën për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore nr. 12, datë 10.09.2024, me kërkues zotin Astrit Kaziu, i cili sipas objektit kundërshton vendimin e KSHZ të datës 13.08.2024, në lidhje me caktimin e shtetases Donika Dedë Karina si anëtare e Këshillit Bashkiak Peqin, nga lista shumemrore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, si në kundërshtim me Kodin Zgjedhor. Nga shorti i hedhur sot në KQZ, relator i kësaj kërkesë ankimore jam caktuar unë, anëtari i KAS-it Elvis Çefa. Verifikojmë prezencën! Është prezent trupa e KAS-it, në përbërje prej katër anëtarësh. Për shkaqe të justifikuara anëtari Braho, nuk është prezent. Kjo nuk e pengon këtë komision që të vijojë shqyrtimin e këtij ankimi. Është prezent po ashtu edhe përfaqësuesja e administratës së KQZ-së, zonja Madalena Koja. Shkurtimisht zonja Koja do të doja nga ju, të parashtroni kërkesën që ka bërë ankuesi në këtë ankim drejtuar KAS-it.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt. 12.09.2024

Znj. M. Koja: Faleminderit zoti Çefa! Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është depozituar kërkesa ankimore me nr. 12, datë 10.09.2024, me kërkues zotin Astrit Kaziu, i cili në objekt ka cituar “Kundërshtimin e vendimit të KQZ-së, datë 13.08.2024, në lidhje me caktimin e shtetases Donika Karina, si anëtare e Këshillit Bashkiak Peqin, nga lista shumemrore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, në kundërshtim me Kodin Zgjedhor”. Ankuesi Astrit Kaziu, me banim në Peqin është anëtar i listës shumemrore të Partisë Socialiste për Këshillin e Bashkisë Peqin, numri rendor 10. Për shkak të vakancës së krijuar, sipas listës shumemrore të subjektit politik Partia Socialiste, në respektim të listës përkatëse të subjektit duhej që ky individ pra, Astrit Kaziu, kandidat të caktohej ai për të plotësuar vakancën dhe jo personi që është caktuar nga ana e KQZ-së. Nga verifikimi paraprak, konstatohet se kërkesa ankimore nuk i plotëson elementët formalë të parashikuara në nenet 126 dhe 130 të Kodit Zgjedhor, për shkak se nuk ka një vendim të Komisionerit në datën 13.08.2024, sikundër referohet në objektin e këtij ankimi. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Faleminderit! Shkurtimisht ju lutem, a mund të na sqaroni çfarë ngjarje ju ka ndodhur në datë 13.08.2024 në KQZ? Ngjarje me të cilën, me sa duket zotëria nuk është dakord dhe gabimisht i është drejtuar KAS-it, duke e konsideruar se është një vendimmarrje e Komisionerit.

Znj. M. Koja: Në KQZ është njoftuar vakanca e krijuar në Këshillin e Bashkisë Peqin dhe sikundër kodi dhe ligji urdhëron është vijuar me identifikimin e kandidatit vijues nga lista shumemrore dhe është vlerësuar që kandidati vijues është zonja Donika Karina. Në datën 13.08.2024 i është dërguar nga ana e KQZ-së, nga ana e Komisionerit kërkesë për plotësim dokumentacioni, zonjës Donika, ndoshta ankuesi i referohet kësaj shkrese, por nuk ka një vendimmarrje ende të Komisionerit.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

Z. E. Çefa: Do të ketë eventalisht një vendimmarrje të ardhshme të Komisionerit për këtë çështje, apo jo!?

Znj. M. Koja: Po, patjetër!

Z. E. Çefa: Dakord. Kolegët ndonjë pyetje, ndonjë diskutim?

Z. I. Rusmali: Jo!

Z. E. Çefa: Atëherë KAS, pasi e diskutoi çështjen në vend, vendosi:

- Moskalimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 12, datë 10.09.2024, të zotit Astrit Kaziu, për shkak se kjo është një kërkesë pa objekt. Nuk ka një vendim, apo akt të Komisionerit të marrë në datën e pretenduar në këtë ankim, i cili të mund të shqyrtohej nga KAS-i. KAS vlerëson gjithashtu që duke qenë se ankimuesi ka një interes të ligjshëm për të qenë prezent në procedurën që do të bëhet nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, vlerëson që t'i rekomandojë administratës së KQZ-së, njoftimin e zotërisë me qëllim dhënien e mundësisë për të qenë prezent në datën kur Komisioneri do të shqyrtojë çështjen për të cilën ka nxjerrë edhe shkresën e datës 13.08.2024. KAS gjithashtu nuk vlerësoi të arësyeshme, duke parë rrethanat e faktit që të vazhdojë më tej me këtë procedim administrativ dhe për këtë arsye vendos, moskalimin për shqyrtim. Të njoftohen palët rregullisht, të njoftohet ankimuesi me këtë vendimmarrje të KAS-it dhe me mundësinë që ai pastaj të marrë pjesë në seancën përkatëse që do të zhvillohet nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Me kaq kjo seancë deklarohet e mbyllur, faleminderit!

Vendimi nr. 21

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*